



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ  
Nr. No. 01-069/01-0045231/24  
Data Date 17.09.2024.



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ, i datës 30.07.2024, ora 10:00.

#### **Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i tri (3) ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2024, me Nr.04-052/01-0032374/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, me Nr.04-400/01-0032372/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
7. Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr.07-030/03-0032405/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DKA-së, **z. Kastriot Duraku**);
8. Informatë për aktivitetet e punës nga Drejtoria e Inspektionit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr. 13-052/01-0034181/24, të datës 22.07.2024, (Raporton Drejtori i DI-së, **z. Valon Haliti**);
9. Raporti i Kompanisë KRU "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023, me Nr.01-052/01-0034126/24, të datës 19.07.2024, (Raporton Aksionari i ndërmarrjes, **z. Ruzhdi Koca**);

#### **Pika shpeshë**

10. Kërkesë për rishqyrtim lidhur me vendimin Nr.01-463/01-0027663/24, për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor, sipas kërkesës së Nr.020-399/3, të datës 18.07.2024, të MAPL-së, me Nr.02-463/01-0035816/24, të datës 30.07.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
11. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

**Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:** I nderuar kryetar i komunës Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, OSBE, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 26 anëtar, mungon me arsye Musa Fazliu, Besart Rrecaj dhe Alketa Mecini, ndërsa bashkëngjitën gjatë mbledhjes Sala Jashari dhe Naser Bajraktari.

Para se të fillojmë me miratimin e rendit të ditës, e kemi një pikë shpeshë për këtë mbledhje;

-Kërkesë për rishqyrtim lidhur me vendimin Nr.01-463/01-0027663/24, për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor, sipas kërkesës së Nr.020-399/3, të datës 18.07.2024, të MAPL-së, me Nr.02-463/01-0035816/24, e datës 30.07.2024..

Shkojmë në votim, për futjen në rend dite:

-Konstatohet me (17) vota për, (2) kundër dhe (6) abstencim. Kërkesë për rishqyrtim lidhur me vendimin Nr.01-463/01-0027663/24, për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor, sipas kërkesës së Nr.020-399/3, të datës 18.07.2024, të MAPL-së, me Nr.02-463/01-0035816/24, e datës 30.07.2024 futet si pikë shtesë, në rend dite.

Shkohet me miratimin e rendit të ditës, e hapë debatin, nëse nuk ka, konstatohet me (16) vota për, (2) kundër dhe (7) abstencim, Miratohet Rendi i Ditës.

Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i tri (3) procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, e hapë debatin, fjalën ja kaloj;

**Hysni Mehani-LVV:** Në procesverbale, po e përmbylli për tri procesverbale, kamë shumë vërejtje, sepse hiqen pjesët kryesore të debatit që për neve janë të rëndësishme, p.sh. shtohet diçka që së kamë thënë, kur kam fol për çështjen e drejtorisë nuk ju kam referuar drejtorit, po ju kam referuar drejtorisë. Edhe unë mendoj që është gabim të fjalë e Sala Jasharit, kjo thotë që ju e keni marrë e keni bërë kandidatë për deputetë, që nuk keni pas në mesin e juaj, në ndërkohë ajo thotë, që i bashkohet juve për me u rizgjedhë serish asamblistë, që besoj që këtu është një gabim që është lëshuar, ajo ka me kandiduar për deputetë po besojë, jo me u rizgjedh asamblistë, kështu që me qenë me të kujdesshme me këtë, së janë dokumente që mbesin.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka shkohet në votim për së cilin Ekstrakt të procesverbalit; me vërejtje nga Hysni Mehani.

-Konstatohet me (26) vota për, (0) kundër dhe (0) abstencim, miratohet Ekstrakti i procesverbalit i datës 07.06.2024.

-Konstatohet me (22) vota për, (2) kundër dhe (2) abstencim, miratohet Ekstrakti i procesverbalit i datës 12.06.2024.

-Konstatohet me (19) vota për, (2) kundër dhe (3) abstencim, miratohet Ekstrakti i procesverbalit i datës 28.06.2024.

Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës;

-Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2024, me Nr.04-052/01-0032374/24, të datës 10.07.2024, (Raporton);

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Fjalë përshëndetëse, para vetes e keni Shqyrtimin e raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2024, është raport i dytë i rregullt për këtë vitë, disa ndryshime që kanë ndodhur nga raporti i parë, janë shtuar 179,566.17€, që janë pjesë përbërës e buxhetit, deri në fund të vitit, që në total kemi një buxhet 18,761,876.17€, duke u menaxhuar, dhe i shpenzuar neper kategori përkatëse. Pjesë tjetër shtesë janë edhe të hyrat vetanake janë realizuara 52.69%, buxheti është shpenzua 57.65%, në paga e shtesa është shpenzuar 62.76%, mallra e shërbime është shpenzuar 54.08%, shërbime komunal është shpenzuar në 47.74%, subvencione 61.06%, dhe në investime kapitale në 47.36%. Kemi një rënjë në krahasim më vitin e kaluar sidomos të tatimi në peronë për arsye së gjatë vitit 2023, kemi falë për qytetaret tatimin në pronë në shumën prej 100€, sipas ligjit. Në faqen 8 janë llojet e shpenzimeve sipas kategorive e nën kodeve, neper të gjitha kategoritë të krahasuara në dy vitet paraprake me të njëjtën periudhë. I keni projektet kapitale, shpenzimet sipas drejtorive dhe zyrave, edhe pjesa e fundit është pjesa e shpenzimeve neper drejtori dhe zyrave, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja;** E hapë debatin, fjalën ja kaloj;

**Afrim Kabashi-NSD:** Fjalë përshëndetëse, drejtor në raport keni theksuar së subvencionet kanë pas shpenzime prej 61.60%, që keni theksuar së janë subvencionuar kryesisht programet e bujqësisë dhe programet tjera, me intereson çka është subvencionuar në bujqësi nga buxheti i komunës, së participimi dallon nga subvencionimi? Disa shpenzime ishin rritë 100% apo edhe me

shume në krahasim më vitin paraprak të njëjtës periudhë si: Shpenzimet e internetit, shuma 4,440.00€, Shpenzimet të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, shuma 10,862.00€, Shërbimet e veçanta konsulentë dhe kontraktore shuma 3,929.00€, dhe a banë me ma sqaru a për çka është ky shpenzim sepse nuk po e kuptoj?, Sigurimi fizik i objektit, shuma 64,850.24€, Mobile me pak së 1000€, shuma 20,523.38€, Furnizimi me pije dhe ushqim (jo dreka zyrtare), shuma 51,489.31€, Dru dhe prodhime të drurit për ngrohje, shuma 126,630.00€, A mundesh drejtor me na tregua përse këto shpenzime kanë pas ngritje kaq shumë me krahasim me vitin e kaluar të periudhës së njëjtë? Të projektet kapitale, kur ka fillua asfaltimi i rrugës Rakinic-Qubrel që po thotë 99.99% u krye? Dhe deri ku kanë mbërritur punimet dhe sa është realizua punimet e kanalizimit në fshatin Polac?

**Hysni Mehani-LVV:** Drejtor, mënyra e raportimit çalon shume, po i ngriti disa çështje tu shprehura që drejtori ka me u përgjigje, të shpenzimet buxhetore thotë: Masa e përgjithshme e paguar për paga ka shënuar rritje në krahasim me periudhën e kaluar kohore të vitit d.m.th. janë shpenzuar 62.76%e fondit aktualë, pjesëmarrja e pagave në shpenzimet e përgjithshme komunale për periudhën janar-qershor 2024 është 61.10%, në shpenzimin e me tepert të kësaj kategorie kanë ndikuar si pasojë e vendimeve gjyqësore. Pra ti thua si pasojë e vendimeve gjyqësore është rritë buxheti në 62.76%, në ndërkohë që të tabela nr.3 vendime gjyqësorë i kemi 12,619.22€, a e kanë rritë në 62.76% pagat këto 12,619.22€, pra kjo është huqje së nuk ka mundësi së pagat janë diku 10 milion €, sipas buxhetit, e ky 12,619.22€, që janë vendime gjyqësorë nuk mundet me arrite këtë shifër, pra qysh është bërë kjo, ne e dimë, po jam ka pres me ma sqarua ti?

Dhe pyetja me e rëndësishme është qysh keni me i mbulua, sepse nëse ju i keni shpenzua 12,619.22€, e 12 muaj i keni, pagat janë fikse 50% për gjashtë muajin e parë e 50% për muajin e dytë, tash i keni shpenzua paret e pagave që fund nëntorit apo dhjetorit mos me pas paga për kategoritë e mësimdhënësve, krejt ato që ti i dinë, qysh ke me i rimbursua këtë deficit që e ke shkaktuar në këtë buxhet? Çka me bëri përshtypje të realizimi, shuma 110 mijë € keni parapa që ka me pas të hyra si pasojë e gjobave në trafik, pyetje me shume për z. Nura, a ndërlihdhet kjo me kërkesën që e keni pas me ja kthye ish komandantin e policisë në mënyre që me përmbush këtë 110mijë€, se ishit shume larg me realizua? Edhe taksat vjetore komunale për biznese qysh e di unë nuk ka qenë tu u aplikua, ju po thoni që ju kemi ndihmua bizneseve, në ndërkohë prej që keni ardhur keni fillua taksen vjetore komunale, a mundesh me na tregua, sa është taksa, dhe përse po i rendoni bizneset? Nenat lehona a po i marrin pagat-ndihmesat që e kemi miratua këtu? Edhe the e kemi fal tatimin në pronë ka ra inkasimi, unë qysh e di tatimin në pronë e kemi fal vitin e kaluar, e ti je tu raportua për këtë vite, gjashtëmuajor? Mirëmbajtja rutinore çka nënkupton, dhe transferet për përfituesit individual tjerë çka nënkupton prej 130mijë€, në 273mijë€, a banë sqarim?

**Kryesuesja:** Sala Jashari dhe Naser Bajraktari janë bashkangjitur mbledhjes, fjalën ja kaloj:

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Shpenzimet për subvencione kanë shkuar neper OJQ, Klube sportive, për Bursa, Rastet shëndetësore, Raste sociale, dhe përfituesit tjerë individual, për Bashkësi islame dhe për qira për raste sociale. Shpenzimet për internet janë rritë për lidhjen e kontratave të reja, për zgjerimin e rrjetit. Shpenzimet e veçanta konsulentë për kontraktor individual, kanë të bëjë për shpenzime që janë paguar për një përmbarues privat, është paguar një anëtarë i komisionit nga shoqëria civile, pastaj kemi një projekt-donacion në drejtorin e arsimit që është paguar një punëtor. Sigurimi fizik i objektit, gjitha janë ato shpenzime të cekura në tabelë skam çka me dhënë me shume as ma pak sqarim. Furnizimet me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), janë shpenzime në dy drejtori të arsimit dhe shëndetësisë, për çerdhe dhe për shtëpinë e pleqve. Shpenzimi në paga, ajo përqindje është shpenzuar një buxhete me shume për këtë 6 muaj, por vendimet gjyqësore paguhen nga çdo kategori aty ku ka mjete, një pjesë e mjeteve janë shpenzuar

nga kategoria e pagave dhe mundeni me i pa në fq. 4 në tabelë. Gjobat në trafik 110 mijë €, të planifikuara, janë realizuara 35,315.00€ ose 32%, në këtë 6 mujor nuk janë hy gjobat në trafik në tre mujorin e dytë, për arsye së ato vinë ka 20 korrik dhe ne e kemi dorëzuar raportin me 10 korrik. Mirëmbajtja rutinore janë do kode që thesari i ka unifikua dhe i quan kështu, janë mirëmbajtja e hapësirave publike, mirëmbajtja e kanalizimeve, e ndriçimeve publike, rregullimi i oborreve të shkollës “Skender Skenderi” Vajnik. Taksat vjetore ne jemi dakorduar që këtu me i ndihmua bizneset me gjithat rregullorja komunale që e kemi miratuar në vitin 2022, disa biznese që ngarkohen me taksa, po jo të gjitha, që janë të cekur në rregullore. Tatimi në pronë kemi ramje të tatimit në pronë, që në vitin 2023 e kemi falur, po pagesat eventuale që janë kryer me herët, nuk janë realizuar për vitin 2024 janë në parapagim qytetar dhe nuk kemi rritje të tatimit në pronë.

**Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj:** Rruga Rakinic-Qubrel është një projekt i vitit 2022-23 janë kanë të parapamë 52 mijë€, kontrata ka qenë 92 mijë€, është një obligim për me mbyll kontratën ka qenë lloje i aneks kontratës dhe ka qenë e parapamë për këtë vite dhe ka përfundua aj si projekt. Kanalizimi në Polac e kemi bë një zgjidhje e kemi kryqe të kodralit tash jemi neper tjera lagje.

**Drejtori i DBPZHR-së, Behzhet Maliqi:** Afrim, pagesat janë bërë me Islamikun, kryesisht me donatoret dhe i kemi pasur disa obligime që janë mbete prej vitit të kaluar.

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi;** Shtesat për lehona, gjatë këtij viti i kemi pasur 224 kërkesa, 87 prej tyre janë realizua pagesat, mirëpo për shkak të kërkesave të shumta për subvencionimin për sëmundje të ndryshme, subvencionimi e lehonave e kemi shtyre në tetor për pjesën tjetër.

**Kryesuesja; Fjalën ja kaloj:**

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, pyetje për drejtorin, shpenzimet për përmbarrim privat që cilët javë kanë marrë për shujta mësimdhënësit, perse nuk ja keni paguar, po javë kanë marr me përmbarrues?

**Hysni Mehani-LVV:** Nuk e kam tendencioze, po raporti nuk është i përgatitur mirë, veç po e citoj çka po thotë: Në shpenzimet e me tepërt të kësaj kategorie kanë ndikuar vendimeve gjyqësore, edhe unë i pash vendimet gjyqësore 12 mijë€, e ti është dashur me na specifikuar që një pjesë e mjeteve është marrë të kjo kategori të kjo tabele, që ne me pas të qartë, kështu kjo është shume e pështjelltë, dhe as një prej këshilltareve komunal nuk e ka të qartë çka ke thënë, boll je mundua me analizua po nuk ke sqarua asgjë veç ma ke pështjelltë, shiko çka thua; Në shpenzimet e buxhetit për periudhën raportuese ka përfitua edhe gjinia femëror nëpër të gjitha kategoritë, për me tepër të dhënat në tabelën nr.3, Tash kjo lenë me nënkuptua që në tabelën nr.3 na i marrim të dhënat çka ka përfituar gjinia femërore, kur e shikon tabelën nr.3 s’ka të bëjë sene me atë, fletë për shpenzimet, pra duhet sqarim me atë çka po prezanton. Të mirëmbajtja rutinore, ndriçimin publik e hapësirat publike, po ato nuk po mirëmbahen ato janë tmerr. Edhe drejtoresha tha po paguhen, po s’po paguhen kjo po i bien pijo, pi paguajna po s’kemi mi pagua deri në tetor, pra s’jeni tu i pagua, dilni me një postim ne faqe tregoni që deri në tetor nuk paguhen lehonat, edhe jemi në rregull.

**Floriana Halili-LVV;** Drejtor të mirëmbajtja e ndërtesave arsimore për vitin 2024, kemi shuma, shumë të larta, pra ne po i shohim çdo ditë që numri i nxënësve po bie, ndërsa shuma e mirëmbajtjeve po rritet?. Ndërsa kur të shohim, shërbimet e arsimit dhe trajnimeve e kemi shumen 8,500.00€, që është diferencë shume e lartë? Edhe të shërbimet kontraktuese tjera, kam kërkuar disa herë ti cekni së çka përfshin këto shërbime, asnjëherë nuk po i cekni, dhe nëse mundeni herëve tjera me i cek, së çka përfshin këto shërbime së nga viti në vite kemi rritje të mëdha?

**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor kam pritë të me jepesh një informacion me të detajizuar, se na shumë mirë e kuptojmë fjalën subvencion dhe participim dhe këtu nuk kemi të bëjë me subvencionim po me participim dhe tjera herë informacionet të jenë ma konkrete.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj:

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Sa i përket raportit 6 mujorë është një raport i hartuar dhe i përpiluar sipas ligjit në fuqi dhe çdo detal e specifikon, dhe nuk mundesh me thanë ky nuk është raport, po ky është raporti ma perfekt sa i përket shpenzimeve financiare. Sa i përket vendimeve gjyqësore shpenzimi i pagave është bërë 62.76%, po përfshihen edhe vendimet gjyqësore, dhe me qenë së vendimet kanë qenë në kategorinë e pagave dhe kryesisht kontratat kolektive dallon prej kategorisë së pagave, shujtat licencimi d.m.th fondi i pagave është shpenzua aq. Dhe rimbursimin e ka për obligim qeveria me i grumbullua pagat për gjithë shërbyesit civil dhe gjitha organizatat buxhetore që e financojnë, për arsye së mjetet janë marr pa na vetë janë ekzekutua, Floriana tjetër herët ti japë përgjigjet.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (4) kundër dhe (1) abstenim përkrah Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2024, me Nr.04-052/01-0032374/24, të datës 10.07.2024,

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023, (Raporton)

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Para vetes e keni, Raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt 2023, dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023. Është një raport që është hartuar nga zyra kombëtare e auditorit, një obligim ligjor që i nënshtrohet çdo organizate buxhetore këtij procesi. Raporti ka pas vlerësim maksimal për komunën tonë, raporti është i pamodifikuar, është dorëzuar edhe plani i veprimit për ato të gjeturat që kanë qenë disa të gjetura teknike të përsëritura, po nuk kanë ndikuar në opinion dhe opinionin është maksimal. Këto të gjetura i kemi adresuar në planin e veprimit në afatin kohor, me A janë gjetje të reja, me B janë të gjetura të përsëritura.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Floriana Halili-LVV:** Drejtor nuk po me dukesh shume seriozë, ma mirë me thanë i këna vjedh ato mjete, e jo tjera herë ta japë përgjigjen.

**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor, ku janë ato të gjetura dhe a munden me u përmisua?

**Abdulla Gashi-IDEAL:** Drejtor gjatë auditimit që është bërë sa gjetje janë dhe në cilat drejtori, dhe për çfarë gjetje bëhet fjalë?

**Hysni Mehani-LVV:** Drejtor the së vlerësimi në komunën tonë është maksimal, pra i kam pa edhe komunat tjera që përgjithësisht pjesa dërmuese e kanë të njëjtën opinion. Sa i përket vlerësimit nuk ka ndonjë opinion ma të specifikuar, pra çka vërehet është tek gjetja 2 të rekomandimet na i kemi 32 mijë € të humbura, të kategoria e pagave dhe shtesave borxhi kryesor ishte 30,169€, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës ka shkuar në 16,658€, dhe në një raste tjetër ka shkuar në 17 mijë €, pra janë 32 mijë € të humbura. Gjatë trajtimit te detyrimeve te papaguara kemi vërejtur se pesë (5) fatura, ne vlere prej 65,408€ nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 39 dite deri ne 300 dite. Vonesat në kryerjen e obligimeve kane shkaktuar kosto shtesë, ku përveç vlerës se faturës komuna kishte paguar kosto shtese përfshirë kamatën, interesin. Tash na e dimë qysh behet korrupsioni përgjithësisht nëpër institucione, merret vesh me një operator, nuk ja pagunë fillimisht punët vonohen aj e paditë në gjykatë në fund i ndajnë, sa është kostoja e kësaj? Po ashtu nga 20 mostrat e testuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kemi vërejtur së në 13 raste, urdhër blerja është proceduar pas datës së faturës dhe pranimit të mallit, shuma totale e këtyre rasteve është 223,499€. Dhe drejtori me flet këtu për një super performancë, këta as 30% të procedurave ligjore nuk i kanë respektuar, kjo i

bien fillimisht vjen malli e she çka ka ardhur madje ja përgatit faturën, kjo lenë mundësi shume të madhe për me vjedh. Shiko çka thotë; në një raste kemi vërejtur së nuk ishte formuar komision i pranimit të mallit, ky raste ka të bëjë me furnizimin me kompjuter për shkollë në vlerë 21,466€ dhe për kundër mos respektimit të procedurës furnizimet ishin pranuar sipas kushteve të kontratës. Pyetja logjike qysh e dinë nëse nuk ka pas komision të pranimit të mallit, qysh e dinë ky që është zhvilluar procedura në rregull, apo ka qenë e obliguar me thënë kështu.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Plani i veprimit është zbatim i rekomandimeve të auditorit të jashtëm ky përfshin çdo gjë, dhe është i përgatitur në fund të këtij materiali të kësaj pike dhe ky i detaizonë edhe të gjeturat edhe rekomandimet por edhe zotimet që do ti ndërmer ekzekutivi, në mënyrë që këto lëshime eventuale teknike mos të përsëriten gjatë viteve aktuale dhe viteve në vijim. Janë të gjetura teknike dhe nuk ndikojnë në opinion të auditimit, ne opinion të auditimit ndikojnë vetëm shkeljet ligjore, po këto nuk janë shkelje ligjore. Të pagesat e faturave mund ndodh ligji thotë 30 ditë dhe mund të harrohen, ke mungesa e komisionit të pranimit, çfarë shkelje është kjo që ndikon në opinion të auditimit. Keq klasifikimi i shpenzimeve nuk ka qenë ndonjë shume që ka reflektuar shume, ne vitin e kaluar i kem ndërmarr vitin e kaluar disa raste me përmbaues privat, ndryshoj ligji për procedurat tatimore, dhe tani kemi filluar një fazë të re, dhe ekzekutimi në përmbaues do ta bëjë komuna duke i pas drejtat ligjore, sidomos të inkasomi i tatimit në pronë. Dhe raporti i auditimit vitin e kaluar ka qenë në korrik.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;

**Hysni Mehni-LVV:** Drejtor, raportin e auditimit nuk është dashur me prezantuar ti hiq. Po thua harrohen, po janë 32 mijë € dëme që ja ke bënë komunës, po është kanë dashur me shkua të shpija ti, dhe me ja pagua komunës krejt demin, së kjo është përgjegjësi, trego qysh është përgjegjësia ndryshe. Drejtor i ke 4 të gjetura të vitit të kaluar që nuk i ke trajtuar hiq, edhe nuk me u përgjigje 20 mostra, 13 të kanë dal që nuk i ke respektuar procedurat, nëse nuk shkelet ligji kur nuk respektohen procedurat, a kanë me tregua qysh shkelet ligji ndryshe, ku fillimisht vjen malli, mase andej e qon faturën.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Raportin financiar për pasqyrat financiare nuk e kam përpiluar unë, e ka përpiluar Zyra kombëtare e auditimit, është organi me i lartë që e kanë vlerësimin në menaxhimin e financave publike dhe përgjithësive, ajo e ka dhënë opinionin, të tjerat janë teknike të përmisueshme nuk reflektojnë në opinion.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (4) kundër dhe (1) abstenim përkrah Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, me Nr.04-400/01-0032372/24, të datës 10.07.2024, (Raporton);

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Para vetes e keni Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, që i shtohen buxhetit aktual dhe destinohen në fondin e bashkëfinancimit në kodin 43870, që i kemi disa kontrata të lidhur për bashkëfinancim me DEMOS-in e MAPL-në si Asfaltimi i rrugës në Klinë të Poshtme, Makerrmal, Ticë, Kopiliq i Epërme, Rakinicë, Ndriçimi publik në qytete, si dhe pajisje për Eko-Natyrën.

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (20) vota për, (2) kundër dhe (1) abstënim miratohet Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024.

Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës,

-Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr.07-030/03-0032405/24, të datës 10.07.2024, (Raporton);

**Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku;** Para vetes e keni Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, janë realizuar gjitha aktivitetet që janë parapa për këtë gjatë mujorë, sipas planit të punës së drejtorisë së arsimit, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Sala Jashari-PDK:** Fjala përshëndetëse, sipas kësaj informate, desha të ndalem të tabela e rezultati i nxënësve nga cikli 6-9, në të cilën po shihet një zbritje të performances akademike të nxënësve, dhe në bazë të kësaj tabele dëshiroj ti bëjë disa pyetje; Si planifikoni të ndërmerrni hapat për përmirësimin e kësaj situatë, konkretisht, a planifikoni të kryeni një analizë të detajuar për të identifikuar arsyen e kësaj rënje, dhe si do të realizohet kjo analizë, cilat masa do të merrni për të ofruar mbështetje akademike shtesë për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë për mësim? A e keni në planë të organizoni trajnime për mësuesit për të përmisuar metodat e tyre të mësimdhënies dhe për tu përshtatur me nevojat individuale të nxënësve, si do të implementohen programet akademike dhe aktivitetet jashtëshkollore për të nxitur interesin e nxënësve për mësim? Çfarë hapash do të ndërmerrni për të nxitur bashkëpunimin e ngushtë me prindërit në monitorimin e progresit të nxënësve dhe krijimin e një mjedisi mbështetës në shtëpi? Çfarë strategjie do të përdoren për të rritur motivimin dhe angazhimin e nxënësve si dhe për të krijuar një mjedis shkollor dhe inkurajues? A planifikoni të vendosen sisteme të rregullta të vlerësimit për të monitoruar progresin e nxënësve dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme në kohe reale, këto pyetje vinë për shkak të përqindjes që po shihet nga 879 nxënës, ose 34.80% janë me sukses të mirë, ne realisht sipas disa statistikave dhe hulumtimeve që janë bërë e dimë që kalimi nga klasa 5 në ciklin 6-9 rrjedhimisht kalohet me disa pasoja për shkak që nxënësit veç janë mësuar me një mësimdhënës për gjatë 5 viteve, dhe po mendoj që është e nevojshme të bëhet një analizë e tillë, në mënyrë që nxënësit tanë mos të kenë këtë ulje të performances së tyre akademike?.

**Abdulla Gashi-IDEAL:** Drejtor the së fillimi i vitit shkollor do të filloj gjithçka në rregull, po shkolla në fshatin në Marinë nuk është asgjë në rregull, dhe disa here kam bërë kërkesë për me intervenua, sepse ajo shkollë nuk ka kushte për mësim, keni intervenuar vetëm të disa qeshmë tjetër asgjë. Qysh donë me fillua viti akademik në shkollën Hamëz Jashari, qysh do të ndjen veten ata profesor, me një drejtoresh që ka bërë plotë skandale, edhe nuk keni ndërmarr ende asgjë?

**Hysni Mehani-LVV:** Të puna e çerdheve, sa kërkesa i keni bërë si drejtori, dhe a i keni plotësua ato dokumente që kërkohen si, parcela, lejen ndërtimorë, që besoj drejtor ti i dinë këto kritere, që ja keni dërguar ministrisë? A ka lëshuar DKA-ja, apo gjimnazi, vërtetim, dëshmi mbi kohëzgjatjen e punës së drejtoreshës në institucione, a keni lëshuar një dëshmi me anë të te cilit e keni plotësuar një normë e një viti pune për me marrë licencën sepse sipas inspektorit të arsimit ajo drejtoresh i ka vetëm dy muaj përvojë punë? Tjetra, e keni zhvilluar një procedurë për me zgjedh një sekretarë të shkollës, e keni zgjedh po keni thënë s'ka shkollë për të, dhe nuk është futur në listën e pagave, tash po e dini për kanë e kam po behet fjalë, a keni me zhvillua procedurë të njëjtë? Tjetra, po thoni së Gjimnazi "Hamëz Jashari" është me tituj të shumtë librash, a kanë me na tregua sa tituj të librave janë? Edhe në të gjitha shkollat e komunës së Skenderajt janë mbajtur aktivitetet të shumta për nder të Epopesë së Lavdishme të UÇK-së dhe 7 Marsit, Ditës së mësuesit, kush e dha urdhrin

që mos me shkua të Jashart, sepse janë shpërnda në rrjetet sociale disa informata, ti duhesh me pas një qëndrim me na sqarua?

**Kryesuesja; Fjalën ja kaloj:**

**Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku;** Sala ne realisht i kemi disa marrëveshje me disa OJQ, dhe mësimdhënësit që janë të akredituare për trajnime do të vazhdojnë të trajnohen të niveli 6-9, dhe raporti i suksesit ne e dimë që një nxënës që kalon në klasën 6-9 është me ndryshe dhe në një ambient me ndryshe, po në gjysmë vjetorin e dytë e kemi një sukses me të mirë të nxënësve. Adbulla shkolla e Marinës është lyrë komplet brenda e jashtë tu kisha lutë shko shikoje, se nuk paske qenë moti. Për çerdhe i kemi bë 7 kërkesa nëpër BL, të Skenderajt, dhe të aprovuara kanë qenë vetëm dy kërkesa për Polac dhe Runik. Vërtetimin për provoj pune për drejtori dhe mësimdhënës e lëshojnë DKA-ja ose gjimnazi. Procedurat e konkursit, rishpallet për çdo vite shkollor dhe vlen për një vite shkollor. Të epopeja e UÇK-së e kam sqarua disa herë dhe asnjëherë nuk i kem ndaluar mësimdhënësit as nxënësit të marrin pjesë neper epope.

**Kryesuesja; Fjalën ja kaloj:**

**Hysni Mehani-LVV:** Thatë se i kemi bë 7 kërkesa për çerdhe e vetëm dy na kanë aprovua, a mundesh me an tregua arsyen përse i kanë refuzuar ato kërkesa për çerdhe? Dhe a ka mundësi me pas kopje atë dëshmi që e ka lëshua DKA, ose gjimnazi atë vërtetim që ja ka mundësua licencimin për zonjën në fjalë?

**Kushtrim Dragaj-PDK:** Fjala përshëndetëse, drejtor faleminderit për përgjigje që ta kam bë për çerdhen e Runikut, shpresoj që nuk neglizhohen procedurat dhe me bë të pamundurën që prej tetorit të paktën me qenë aktive çerdhja, pasi që objekti nuk ka nevojë shume për renovim.

**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor nëse kish pas mundësi me u ngritë cilësia e arsimit, së në bazë të raportit që po e shohë ka ra cilësia, që në të kaluarën cilësia ka qenë e barabartë si në qytet po edhe nëpër fshatra. Edhe një lajmë i mirë për çerdhen e Polacit, shpresoj nuk neglizhohen procedurat dhe të filloj çerdhja.

**Kryesuesja; Fjalën ja kaloj:**

**Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku;** Kërkesa për çerdhe i kanë refuzuar për arsye se nuk ka kapacitete të numri i fëmijëve, sipas një analize që e kanë bë. Për Polac e Runik, këto dy BL, kanë shumë fshatra për rrethe. Bane një kërkesë për qasje në dokumente edhe e shikon vërtetimin. Kushtrim sa i përket komunë dhe DKA-së i kemi dorëzua gjitha dokumentacionin e kërkuara, komuna e ka një kontratë projektuese, dhe ata janë mbete me diskutuar me ministrin rrethe një çështje të vogël dhe sot gjatë ditës sqarohet gjithçka, dhe ka me ju njoftua me kohe.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (5) kundër dhe (2) abstenim, përkrahjet Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës,

-Informatë për aktivitetet e punës nga Drejtoria e Inspekcionit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr. 13-052/01-0034181/24, të datës 22.07.2024, (Raporton);

**Drejtori i DI-së, Valon Haliti;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni pas me kohe Informatë për aktivitetet e punës nga Drejtoria e Inspekcionit për periudhën janar-qershor 2024, në kuadër të kësaj informate janë përcaktuar objektivat e përgjithshme të drejtorisë, në fushat që i mbulon kjo drejtori, në këtë periudhe janë shqyrtuar 182 lëndë, 156 lende janë miratuar, 13 lende janë refuzuar, dhe 13 lende janë në proces. E kemi inspektuar fushën e tregut, fushën e komunikacionit, fushën e mbrojtjes së mjedisit, fushën e ndërtimit. Materialin e keni pas me kohe kush ka pyetje shtesë për sqarim jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:



**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor në kuadër të këtij raporti i kam disa çështje për me i ngrit, që edhe vitin e kaluar kam theksuar, në evidentimin e deponive ilegale të vendosen tabela sinjalizuese që shumicën e rasteve nuk kanë treguar sukses, a ka vazhduar i njëjti avaz, a keni marr ndonjë masë me të ashpër që me i ndalua ato hedhje ilegale vend e pa vend të mbeturinave? Edhe kush po donë po vendos pengesa para lokaleve, a janë të rregullua me ligj ato pengesa apo janë dëshirë e pronarëve të lokaleve?

**Besiana Thaçi-PDK:** Fjala përshëndetëse, drejtor faleminderit për raportin, e kam një pyetje sa i përket fushës së komunikacionit, e kam bë me herët një kërkesë për dy pasqyre për kyçje në rrugën kryesore Mulla Ilaz Buroja, në fshatin Burojë, mirëpo ende nuk ka diçka konkrete, po e përsërisë, nëse ka mundësi me u vendos ato pasqyre, sepse në një nga vendet ka pas edhe raste të aksidentit.

**Hysni Mehani-LVV:** Drejtor a mundesh me na tregua në përqindje sa mendon është tu u respektua Harta zonale, dhe kriteret e ndërtimit në Skenderaj? Edhe më bëri përshtypje mos respektimi i orari të punës për mos respektim të rregullores komunale, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës është shqiptuar një gjobë, a ja keni shqiptua këtë gjobë vetit, që nuk po e respektoni këtë rregullore, së nëse është shqiptua vetëm një gjobë, është dashur me ja shqiptua vetit së ju nuk jeni tu e respektua, qysh ka kuptim me gjobit një qytetar, ose shkoni kërkoni falje ose ktheja paret, së e keni gjobit dikën e ju nuk jeni tu e respektua këtë rregullore.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DI-së, Valon Haliti;** Afrim është shqetësuese hedhja e mbeturinave vend e pa vend, këtë po e bëjnë qytetaret e pandërgjegjshëm, nuk po kemi mundësi me kap së cilin. Sa i përket bllokimit të hapësirave publike është e vërtet, inspektorët janë të angazhuar për me inspektua, po 80-90%, të rasteve janë të pajisura me leje të parkingut. Besiana, siguroj që gjatë kësaj jave kemi me bë vendosjen e pasqyrës. Hysni, të përqindja, është tu u përfill diku 80-90% lejet e ndërtimit dhe harta zonale, nuk jam ekspert i fushës, po gjithmonë po flasë në bazë të vlerësimeve dhe komenteve që i jepe drejtori i fushës. Të gjoba për mos respektim të orarit të punës, ne kemi marr veprime në bazë të rregullores të kuvendit, nuk jam me gjobit askënd, qëllimi imë është me dhënë këshilla, po kur po behën dy tri vërejtje s'po kam qare pa i dënua.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Mentor Mehmeti-PDK:** Fjala përshëndetëse, drejtor i kam 3 shqetësime; është koha e djegieve të hamullorëve, a keni me bë parandalimin, a keni me shkua me inspektua? Është koha e dasmave ka shume zhurmë jashtë orari? dhe, të taksitë a kish pas mundësi si komunë, në bazë të ligjit, me ju thanë kompanive të taksive me e siguria një veturë për personat me aftësi të kufizuar?

**Ali Lutfiu-PDK:** Drejtor a ka mundësi me ndërhy diçka rrethe dëmtimeve të parku i qytetit?

**Osman Smajli-IDEAL:** Drejtor gjatë vizitave që i keni bë nëpër punishte, të lejet e ndërtimit, a shkoni me kërkesë të DUMA-së apo shkoni në bazë të ankesave të qytetarëve?

**Abdulla Gashi-IDEAL:** Drejtor sa i përket deponive ilegale a ka mundësi si drejtori, me ja bë një trusni me të madhe Kompanisë Uniteti, për me shkua me kohë për me i hekë mbeturinat neper kanta sepse shpesh herë me tri javë nuk vinë me i largua mbeturinat dhe qytetaret obligohen me i hedhë diku tjetër.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DI-së, Valon Haliti;** Mentor lidhur me djegien e hamullorëve është shqetësues ditëve të fundit, po inspektimi i parandalimit të zjarreve dhe fatkeqësive tjera funksionon në kuadër të DSHP. Sa i përket zhurmës nga dasmoret, prishja e rendit dhe qetësisë publike është kompetencë e ministrisë punëve të brendshme. Të pjesa e dëmtimit të parkut të qytetit, monitorimin e kamerave e bëjnë policia në Skenderaj, dhe për personat me aftësi të kufizuar ka me u interesua me ja siguria një taksi për këtë kategori. Osman ne për çdo leje që e lëshon DUMA, inspektori i ndërtimit është

i obliguar me e përcjell në tersi projektit. Është e vërtet Abdulla që ka pas vonesa në mbledhjen e mbeturinave nga kompania uniteti, i kemi kërcënuar në kuptim pozitiv, që me i gjobitë nëse vazhdoni kështu me vonesa ne mbledhjen e mbeturinave.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (20) vota për, (1) kundër dhe (4) abstënim, përkrah Informatë për aktivitetet e punës nga DI-së, për periudhën janar-qershor 2024,

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës,

-Raporti i Kompanisë KRU “UNITETI” Mitrovicë, për vitin 2023, me Nr.01-052/01-0034126/24, të datës 19.07.2024, (Raporton);

**Aksionari i ndërmarrjes KRU “UNITETI” Mitrovicë, Ruzhdi Koca;** Fjala përshëndetëse, unë jam Ruzhdi Koca, aksionar në ndërmarrjen KRU, “Uniteti” Mitrovica, para vetes e keni Raportin e kompanisë KRU “UNITETI” Mitrovicë, për vitin 2023, e ka raportua në pika të shkurta, raportin para anëtarëve të kuvendit, kush ka pyetje jam këtu për çdo sqarim shtesë.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Raportimi për Unitetin Sh.A njësia ne Skenderaj. Ne këtë raport që keni sjell pas tri vitet qeverisje kjo tregon shume se ju nuk jeni transparent dhe kredibil për të raportuar para kuvendit. Do ishte mire që kritikrat dhe këshillat e mia ne seancat e kaluara kur kam kërkuar që të sillni për çdo vit raportin për ndërmarrjen Uniteti Sh.A njësia në Skenderaj mos ti injoroni këshillat por ti sillni me kohe siç e kërkon baza ligjore së jeni të obliguar të raportoni për çdo vite kalendarik. Përmes këtij raporti për Unitetin njësia në Skenderaj me shumë keni fol kur është themeluar se problemat dhe keq menaxhimin e kësaj ndërmarrje. Ky raport është për të ardhur keq dhe çka është dhe më e rënda për asamblistët te PDK-se që lejon me raportuar përfaqësuesi i aksionareve ku nuk ka njohuri se qa behet ne këtë ndërmarrje, duke marre për bazë se ne këtë ndërmarrje veç ne njësinë ne Skenderaj janë dy menaxher dhe një zëvendës menaxher, qa është edhe me skandaloze për këtë raport, nuk ka marr guximin më raportuar as anëtari i bordit z.Faton Zeka i cili ne baza mujore paguhet për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kësaj ndërmarrje. Me qene se keni sjelle këtë raport qesharak unë kam disa pyetje për sqarim:

1. Ku është raporti i auditori për KRM UNITETI SH.A Mitrovicë pse nuk e keni sjelle edhe raportin e auditori?
2. Pse nuk e keni sjelle listën e punëtorëve të njësi në Skenderaj?
3. Sa janë pagat e menaxherit dhe sa jenë pagat e punëtorëve të operatives?
4. Ne bazë të raportit nga muaj shkurt 2023 ju keni rritë rrogat për nga 100€, punëtorëve të operatives, por nuk jave keni rrit pagat punëtorëve të makinerisë dhe kryepunëtorit? P.sh. Kryepunëtori të operatives z. Ilmi Hajra, Mekanikut Faton Xhema dhe Elektricitistit të makinerisë z. Shaip Dibrani i cili ka të vrarë katër anëtar të familjes gjate luftës, Nënë me tri motra i cili nuk e ka gjendjen e mire ekonomike, pse nuk e keni ngrit këtë çështje ku qëndron problemi?
5. Ne njësinë ne Skenderaj jam të angazhuar tre punëtorë mekanikes dy punëtor të mekanikes nuk jave keni rrite rrogën prej 100€, ndërsa njërit mekanik të preferuar keni bërë dallim ne rroge, ndërsa edhe mekaniku Faton Xhema ka dy anëtar të familjes të vrarë gjate luftës dhe bëni diskriminim të paparë ndërmjet punëtorëve ne paga?
6. Sa është numëri i punëtorëve të lënduar gjate punës, pse nuk po merreni më trajtimin e këtyre punëtorëve të lënduar rend si p.sh: punëtori fizik Muhamet Deliu i lënduar rend, Vesel Shala i shtypur me kamion, Bajram Maliqi me lëndime të rënda trupore dhe shume punëtorë të tjerë që ju nuk i keni raportuar për gjendjen e tyre shëndetësore?
7. Pse punëtorët e operatives nuk kam uniforma, ku dihet se janë të rrezikuar ne rrugë dhe nga infektimi gjatë punës?

8. Cila është gjendja e kamionëve të njësisë, ku dihet se një numër i makinerisë edhe ne cun ga që rrinë po ju shpenzon nafte?

9. Përse kamionët kur i keni defekt i dërgoni në Ferizaj, ku është punëtorja në Mitrovicë?

Duke e lexuar këtë raport me shume ka të dhëna imagjinare sipas dëshirës së menaxhmentit së sa prej gjendjes reale që është tek kjo ndërmarrje totalisht e shkatërruar nga keq menaxhimi, me pas kane menaxhimi i mire nga Kryeshefi aktual dhe bordi i drejtoreshave njësisë e Komunës së Vushtrrisë nuk ish shkëputë nga bashkëpunimi, po si duket pa aftësia e dy kryetarëve aktual kanë mbetur dy komuna pa shërbim cilësor për qytetarë dhe punëtorëve të kësaj ndërmarrje. Kryetar mos hezito si asamblistë të IDEAL-it jemi të gatshme të mbështesim në shkëputjen e njësi Uniteti në Skenderaj, për të ju bashkuar ndërmarrjes komunale Eko Natyra Sh.A sikurse ka bërë Komuna e Vushtrrisë me ndërmarrjen Përparimi Sh.A.

**Abdulla Gashi-IDEAL:** I kam disa diskutime, po merri si kërkesa, pagesat e qytetarëve për pagesa të mbeturinave janë tu i bë në masë të mirë, po qytetarët nuk janë të kënaqur me shërbimet e kompanisë Uniteti, sepse mbeturinat nuk i marrin me kohe? Sa i përket makinerisë një pjesë e tyre nuk janë në gjendje as në rrugë me dalë, ndërsa mu ka erqethë trupi kur një shofer me ka thënë që nuk kanë as kushnica ato makineri, që është mjerim. Dhe kisha kërkuar nga qytetarët që pagesat për mbeturina ti bëjnë me fatura, e jo me pare kesh. Menaxhimi i kompanisë është shumë i dobët, dhe kushtet e punëtoreshave janë në mjerim, dhe kërkoj nga ju që ti ngërisni këto kërkesa?

**Hysni Mehani-LVV:** Ky raport është gjithëpërfshirës, ish kanë dashur me qenë një raport që i adresohet vetëm komunës tonë, ku paraqitet puna, po edhe sfida, edhe ajo çka mundem me i ndihmuar si komunë si institucion si kuvend komunal, a keni dërguar kërkesë ndonjëherë të bordi i kompanisë, e lexova që komuna e Mitrovicës ja paska dhënë dy kamion, aksionet tona janë të vogla 10% si komunë, po nevojë kemi shume të madhe, edhe ishin rritë ekonomit familjare dhe kjo ish kanë dashur me reflektuar rritjen e aksioneve e përqindjes. A keni propozuar diçka ndonjë kërkesë, ndonjë sugjerim kompanisë që ne kishim mundur me bë si komunë?

**Kushtrim Dragaj-PDK:** Fjala përshëndetëse, pas konsultimit me drejtorin e shërbimeve publike, në fshatin Leqinë është bë furnizimi me kontejnerë familjet që kanë dëshiruar me i pas, po problemi është së nuk po keni kamion me të vogël për me i shkua me i marrë mbeturinat të ato familje, a ka ndonjë strategji qysh duhet me vepruar, që me i krye shërbimet të ato familje? Edhe nëse veç merret vendim me u vendos një kontejnerë me i madh në BL-Runikut për bizneset të cilët nuk posedojnë kontejnerë, që shumica e bizneset mbeturinat i vendosin në kontejnerë të shkollës, a është ndonjë mundësi për transportin e kontejnerëve të hapur, që me vendos diku në Runik dhe me përdor qytetarët për hedhje të mbeturinave?

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj:

**Aksionari i ndërmarrjes KRU "UNITETI" Mitrovicë, Ruzhdi Koca;** Të nderuar të gjitha pyetjet në bazë të legjislacionit në fuqi, i raporton komisioni i aksionarëve, unë me sinqeritetin me të madhe ju them së të gjitha pyetjet, kërkesat, sugjerimet që i bëtë, i kamë marrë edhe prej njerëzve të zakonshme, po edhe nga bizneset, dhe z. Bajraktari për ato specifika nuk kam njohuri, po i kam marrë dhe ka me i përcjellë të anëtarët e bordit dhe të anëtarët e aksionarëve. Dhe besoj që shume shpejtë këto kompetenca ka me i marrë kompania Eko natyra Skenderaj.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (20) vota për, (1) kundër dhe (5) abstenim, përkrahjet Raporti i Kompanisë KRU "UNITETI" Mitrovicë, për vitin 2023.

Vazhdojmë me piken 10 të rendit të ditës;

-Kërkesë për rishqyrtim lidhur me vendimin Nr.01-463/01-0027663/24, për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor, sipas kërkesës së Nr.020-399/3, të datës 18.07.2024, të MAPL-së, me Nr.02-463/01-0035816/24, e datës 30.07.2024, (Raporton);

**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Kjo pikë ka ardhur me kërkesë të MAPL-së lidhur me vendimi për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor, nga seanca e kaluar, e që autoritetet mbikëqyrës të MAPL-së, e kanë bërë një gabim në kuptimin e vlerësimit që ndërlidhet me listën e dhënies në shfrytëzim të pronave sepse nuk i ka definuar saktë parcelat e cila nuk figuron një vite për dhënien në shfrytëzim po është dhënie afatgjate, pasi e kemi marrë konfirmimin nga ministria, një kontakt me ta konsultativ e kanë vërejtur edhe ata, edhe na kanë kthyer jashtë afatit ligjor prekluziv prej 15 ditësh, po për shkak të proceseve dhe procedurave të performances që kërkohen kam vendosur me sjell në kuvend dhe ta rikonfirmojmë vendimin që e kemi marrë në seancën e kaluar për parcelën apo objektin banesor të familjeve të dëshmorëve. Dhe takimin që e ka pasur sekretaria dhe zyra ligjore në departamentin e vlerësimit e këtyre akteve, edhe ata e kanë pa që e kanë bërë një lëshim, vendimi është krejtësisht në baza ligjore.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Hysni Mehani-LVV:** Në listën për dhënien e një pronës komunale në shfrytëzim fillimisht duhet me u publikua vitin paraprak që ka me u dhënë gjatë viteve në vazhdim, e në raste konkret ministria po thotë se kjo parcelë është planifikuar me u dhënë prej 0 deri 1 vite, e kjo nuk shkon hiq sipas ligjit, po shkon sipas rregullores, ministria po thotë kështu. Nëse ministria ka gabua në vlerësim të ligjshmërisë e na po e kthejmë në rishqyrtim ish kanë dashur me ja kthye, besoj Jetoni mundet me na shpjegua, se a ka kërkuar sqarim shtesë para së me marrë vendim për rishqyrtim ministria, sepse ministria ka marrë vendim pa kërkesë është në rregull. Thash sipas asaj që po arri me lexua na duhet me pritë me kalua ky vite, këtë pronë me shtim në listën e pronave prej 1 deri 99 vite për me muajt me procedua tutje. Tash këtë vendim që po e lexoj ministria nuk po e konteston veten kohëzgjatjen, po e konteston edhe kriteret që nuk janë respektua për dhënien e pronës të paluajtshme në shfrytëzime, kështu po e lexoj unë. Sepse unë, sa herë ka ardhur ky vendim e kam votua, edhe e votoj prapë, sepse është temë e ndjeshme që ka të bëjë me UÇK-në, ama ish kanë dashur me analizua, me pyet shume, për me ja lidh kryet kësaj pune mirë. Sepse nëse shkojmë sipas ligjit, të kriteret është çdo herë në të tri format që jepet prona, çdo herë është interes i komunës, ligji nuk e di unë tregomini, ndihmomini dikush së ku e specifikon së ky ligj thotë që një pronë e komunës mundet me u dhënë në shfrytëzim falas, unë nuk e di së thotë dikun.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;

**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Është vendim që është në fuqi, ministria i ka shkel afatet, dhe s'ka kush që e konteston, edhe ministria vendos qind për qind të rasteve mbi bazën e dokumentacionit, përjashtimisht kur komuna kërkojnë konsultim paraprak, ose konsultim masi të vjen një kërkesë për rishqyrtim, na e kemi bërë, kemi pas takim, dhe ata e kanë pa që kanë gabua të numri i parcelës. Listën që e kemi marrë këtu që është e publikuar për vitin paraprak e lista është për këtë vite, d.m.th. e kanë gabua numrin e parcelës dhe e kanë kualifikuar për një vite. Edhe një prej komunave e ka krye në këtë formë pikërisht për këto familje. Ju rritet vlera ati objekti sepse ati objekti banoret ju nënshtrohen tatimeve në pronë të buxhetit të komunës, dhe i rritet vlera e atij objekti.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (26) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, përkrah të Kërkesës për rishqyrtim lidhur me vendimin Nr.01-463/01-0027663/24, për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës objektin banesor, sipas kërkesës së Nr.020-399/3, të datës 18.07.2024, të MAPL-së.

Vazhdojmë me piken 11 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj;

**Hysni Mehani-LVV:** Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: 1. Gjatë këtij viti drejtoria që ju drejtoni ka dhënë makina mbjellëse të misrit. Ndër kriteret që ishin përcaktuar me rastin e shpalljes së

thirrjes ishte që aplikuesit të kishin të mbjellur kulturën e misrit gjatë vitit 2023 dhe të planifikojnë mbjelljen e kësaj kulture në vazhdim. Mirëpo ky kriter nuk ishte respektuar nga drejtoria që ju drejtoni, ku në njërin nga seancat ju keni thënë se e keni marrë parasysh certifikatën familjare që dëshmon së njëri nga familjarët e kishte të mbjellë këtë kulturë, madje edhe në një prononcim publik e kishit pohuar këtë duke thënë se: “problemi është se ka aplikuar burri, por gruaja është për subvencione. Veç qisi raste janë së nuk ka asnjë familje (përfitues) që nuk ka pasur të mbjella.” Ndërkohë, që në një dokument që i keni dërguar AIP i cili mban nënshkrimin tuaj, ju kishit thënë se në marrëveshje me “Islamik Relief” ju kishit vendosur të mos kërkonit fare dëshmi mbi hektarët e mbjellura me misër, por kishit vendosur që vlerësimin ta bënte komisioni në terren. Cila është e vërteta, ajo që i thoni në medie apo ajo shkruani për AIP? Tutje, ishit marrë vesh me Islamic Relief që komisioni vlerësimin ta bëntë në terren sipas gjendjes reale, ndërsa AIP-it i deklaroni që komisioni kishte vlerësuar në mënyrë diskrecionale!

I nderuari drejtor, a mund të na tregoni çka do duhej të ndodhte tjetër sipas jush që ky proces të quhet keqpërdorim, korrupsion apo hajni, emërojeni sido që është më e pranueshme për ju, dhe a ka raste tjera që keni vepruar njëjtë? Shih dokumentet në material!

2. Për Drejtorin e bujqësisë: A ka raste që edhe pas publikimit të emrit të fermerëve si përfitues të makinës mbjellëse të misrit, fermerët nuk i kanë marrë makinat mbjellëse të misrit? Sa raste janë dhe për cilat arsye iu është anuluar subvencionimi, si dhe, cila është baza ligjore dhe me cilën kategori sipas rregullores komunale për subvencione i keni shpërndarë këto makina mbjellëse të misrit?

3. Për Drejtorin e financave: Sa është vlera e kontratave që keni nënshkruar prej se keni marrë mandatin si qeverisje?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi:** Hysni, ti je dëshmitar që këto lende i ke dërgua në polici dhe prokurori, na besojmë të organet e drejtësisë, po presim derisa organet e drejtësisë të japin versionin, na e konsiderojmë që çdo ndërhyrje që e bëjmë, është ndërhyrje në drejtësi qëllimi ynë nuk është ky, po e presim vendimin e organeve të drejtësisë, dhe mas andej jemi të gatshëm me u ballafaqua me çfarëdo pyetje që ta kesh.

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu:** Numri i kontratave të lidhura për tri vite janë 198 kontrata, për vitin 2022, janë 81 kontrata, 2023, janë 79 kontrata, dhe për vitin 2024, për këtë 6 muaj janë 38 kontrata, me një shume prej 24,154,972.00€, dhe të gjitha këto kontrata janë të publikuar në faqe të komunës, kontratat janë të lidhura nga, 1 vite, 2 vite, dhe 3 vite, janë kontrata kornizë dhe të bazuara në ligj.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Floriana Halili-LVV:** Pyetjet për Drejtorin e bujqësisë; Pse s'po vazhdon dhënia e mëshjtjerrave si vitet paraprake, keni hapur thirrjen fermerët i kanë dorëzuar dokumentet pak para se t'i shpalleni rezultatet e keni ndërpre, pse?

Pyetjet për Drejtorin e Shëndetësisë; A është e vërtetë që barnatorja e privilegjuar e Fadil Nures, vazhdon ta vjedh rrymën prej QKMF-së? E kam fjalën për barnatoren ku ishte pediatria, e që z. Nura ia dha një bashkepartiaku.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi:** Na thirrjet nuk kemi me i ndërpre kemi me vazhdua, jemi në bashkëpunim me disa donator tjerë, dhe pritet me hap thirrje.

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi:** Personi që e ka marrë në shfrytëzim lokalitë e komunës, në momentin që e ka nënshkruar kontratën e ka ndërpre njësinë elektrik, dhe e

paguan vetë rrymën, dhe nuk e vjedh as prej QKMF-së dhe askund tjetër, dhe këtë ta dëshmoj me fatura.

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** znj.Haliti ma përmendi emrin, po dua me i tregua që shpifja dhe shamia nuk shkojnë bashke, me shariat është e dënuar shpifja, ose nuk din, ose lexo, ose kur të vish me bë pyetje të jesh me konkrete, ke drejtë me pas qasje në dokumente zyrtare, është hetuar prej prokurorisë, e dinë kolegu yt, e ka marr vendimin. Shpifja është e keqe edhe në aspektin fetar, ligjor e institucional është e dënuar, dhe të kisha rekomandua të jesh e kujdesshme, sepse kam admirim ndaj shamisë e respektoj fort, po kur e ke shaminë ki kujdes dhe kësaj radhe po të kursej për respekt të shamisë.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Floriana Halili-LVV:** Faleminderit drejtoresh, duhet me kërkua qasje në dokumente me i shikua ato fatura. Z. Nura, unë bëra pyetje se di perse tu doke ty diçka e tillë, dhe tu kisha lutë që shaminë mos e përzini këtu, dhe çka kini ju ndaj shamisë dhe e dini qysh i keni përjashtua vajzat me shamia prej shkolle, dhe tu kisha lutë që me këtë temë është mirë me u kursye e mos me hap hiq temën e saj.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** E nderuar ti me ke thënë po vjedh të një i privilegjuar i jemi, ti mua me ke thënë hajn, dëshmojë këtë, së e ke shaminë e është keq fëtarishtë, që kodi penal i fesë islame, fyerjen e kualifikon si vepër të ultë, dhe nuk kisha pas qef me u marr me kësi gjera në kuvend.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Floriana Halili-LVV:** Mulla Nura të lutna mos i përzije këto tema, kjo është veç pyetje, unë jam këshilltare komunale dhe kam drejtë me bërë pyetje, e ti qysh e merr është krejt diçka tjerë.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Besiana Thaçi-PDK:** Fjala përshëndetëse, sa i përket pyetjes së Florianes, dhe përgjigjes së drejtoreshës, se di perse ju përgjigjet në pyetje tilla të ulëta, me na hup kohe këtu palidhje.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Abdulla Gashi-IDEAL:** Pyetje për drejtorin e urbanizmit: Drejtor, a e keni ne plan me ndërmarrë diçka ne përmirësimin e kanalizimit ne degëzimin qe lidhet me Drenas? Është shume e nevojshme me intervenua ne këtë pjese, me i largu aromat e këqija qe janë afër kompleksit memorial te dëshmoreve ne Marine?

**Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj:** I kemi punuar rreth 50 metra kanalizim pas hekurishtes, është punuar një pusët dhe po shpresojmë së kemi me i trajtua edhe këtë vite, po nëse kemi mundësi buxhetore, dhe ka shume probleme me kanalizime.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Kushtrim Dragaj-PDK:** Për pyetjen e parë kam marr përgjigje, po i lexoj pyetjen e 1 dhe 2. Pyetje për drejtorin e urbanizmit I nderuar drejtor ,në dëgjimin buxhetor ne Runik pyetjes se banorëve të Leqinës ju keni premtuar qe së shpejti do të fillon zgjerimi dhe shtrimi i rrugës në lagjen Dragaj që e lidh me shkollën e vjetër dhe rrugën e vetme ne lagjen Dragaj që dërgon për të shtëpia e familjes së se 2 dëshmorëve dhe 1 martiri ? Pyetje për drejtorin e urbanizmit Deri ku kanë shkuar procedurat e subqendres së Runikut?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj:** Kushtrim sa i përket premtimeve, premtimet i kemi mbajt, i kemi shti në projekt, rruga Surigan, në kuadër të kësaj rruge janë edhe tri kilometra rruge neper fshatra Qitak, Leqin, dhe Padalisht, ti shohim mundësit buxhetore sa po mujna me i trajtua, për subqendren në Runik, në vitin 2023 është lidhur një kontratë, ka qenë e paraparë edhe shtëpia e

kulturës pastaj është lidhur një memorandum me ministrin e kulturës, ministria i ka pas 50 mijë €, për vitin e kaluar dhe nuk ka paguar sene. Një obligim për rrethoj me llamarinë të shtëpi së së kulturës na ka mbet neve si obligim, tash jemi në fazën përfundimtare riformatimitë dhe për me hekë shtëpinë e kulturës prej subqendres, siç e dinin javën e kaluar i kemi asfaltuar njo 3-4 rruge të cilat kanë qenë të parapara për asfalt në kuadër të subqendres, jemi duke punuar, dhe e kemi rrezuar edhe objektin e fundit në Runik, jemi tu punua me tretuar me kubza.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Afrim Kabashi-NSD:** 1. Për Kryetarin Fadil Nura; Kryetar cilat janë arsyet e mos pagesës të mëditjeve për mbajtjen e mbledhjeve për anëtarët e Komitetit për komunitete kur dihet se komiteti i komuniteteve është komiteti i përhershëm?

2. Për Drejtorin për Shërbime publike; Drejtor, kam pranuar shqetësime nga ana e qytetarëve të cilët e kanë breg problemën e kundërmimit nga ujerat e zeza të cilat dyshohet që janë si pasoje e bllokimit të kanalizimit të ujerave të cilat rrjedhin nga fabrika e përpunimit të mishit në Polac, po ashtu shqetësimi i njëjtë vjen edhe nga banoret e fshatit Rrezall e Re, që dalin nga Impianti i ujerave të zëna në Llaushë, që kundërmon erë e keqe?

3. Për Drejtorin për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale; Drejtoresha a planifikoni që në planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm në rritjen e subvencioneve për nenat që lindin fëmije, se disa komuna për çdo lindje e kanë shume 500€.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:


**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Afrim, unë personalisht jam marr për këtë çështje me personelin, po ka ndryshua një UA, i kanë përcjell me kohe listat për MF, dhe ministria nuk janë ka i ekzekutojnë pagesat, këtë problem po e kanë edhe komunat tjera, jemi tu bërë përpjekje me i kompensua ato pagesa retroaktive anëtareve të komitetit, po nuk është në dorën ton Afrim.

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala:** Fjala përshëndetëse, Afrim jemi tu punua për këtë çështje të kanalizimit që ajo aroma po vjen prej fabrikës së përpunimit të mishit në Polac, kemi ndërhy njo 4 herë në bllokimin e gypit, po DUMA, me DI, dhe pronarit të fabrikës janë në proces të zgjedhjes së këtij problemi për krijimin e tri gypave septike për këtë problem.

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi:** DSHMS-së, siç e dini ka bërë rritjen e subvencioneve për lehonat 100% të vlerës që ka qenë me herët, dhe nuk e kemi ndërmend njëherë me bërë rritjen, për arsye të këtyre viteve, grandit për shëndetësi ka pas rritje prej 3%.

**Kryesuesja:** Me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit